

VENDIM
Nr. 777, datë 19.12.2025

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 554, DATË 31.7.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË
FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE
AFTËSIVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 14, pika 3, dhe 15, pika 6, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar; të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës “p”, të pikës 8, të kreut III, të vendimit nr. 554, datë 31.7.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet shkronja “q”, me këtë përmbajtje:

“q) mbledh dhe administron informacion mbi vendet e lira të punës të shpallura nga punëdhënësit e sektorit publik e privat.”.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama